



Nënshkruhet Memorandumi i Mirëkuptimit midis Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" dhe SWISSCONTACT

Qëllimi i këtij memorandumi, është të krijohet një marrëdhënie reciproke të dobishme, të ndërtaur mbi bashkëpunimin akademik, shkencor dhe kulturor, si dhe të përcaktojnë fushat për kërkimin shkencor e akademik, në të cilin palët dëshirojnë të punojnë së bashku në të ardhmen, për përfitimin e tyre të ndërsjellë, për të nxitur një kuadër bashkëpunimi me synimin për të fituar nga iniciativat dhe procedurat e punës së njëritjetrit. Projekti "Aftësi për punë" është një projekt i hartuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, në bashkëpunim me qeverinë shqiptare, për zbatimin e të cilit është kontraktuar Swisscontact.



Aleanca kundër gjuhës së urrejtjes një diskutim gjithëpërfshirës

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, Avokaten e Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Autoritetin e Mediave Vizive, zhvilluan aktivitetin me temë "Aleanca kundër gjuhës së urrejtjes një diskutim gjithëpërfshirës". Rektori i universitetit, Prof.dr.Skender Topi, në fjalën e tij përshëndetëse, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit shoqëror dhe institucional në parandalimin e fenomenit të diskriminimit dhe të përdorimit të gjuhës së urrejtjes. Gjithashtu ai u ndal në situatën aktuale në të cilën po kalon Evropa, duke shprehur solidaritetin në distancimin nga çfarëdolloj forme e dhunës, mbrojtjen dhe ruajtjen e demokracisë e paqes.

Ekspozita "Elbasani i viteve 1916-1918"



Bashkia Elbasan, në bashkëpunim me departamentin e gjuhësisë në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", ka organizuar me rastin e festimeve për "Ditën e Verës", ekspozitën "Elbasani i viteve 1916-1918". Përmes kësaj ekspozite me foto të rralla nga Arkivi i Vjenës (mundësuar nga Arkivi Digjital i Elbasanit), studentë, profesorë, studiues dhe qytetarë të Elbasanit, kanë mundësinë të njohin në terësi, kontributin që qytetarët Austro-Hungarezë kanë dhënë në fushën e arsimit, infrastrukturës, kulturës dhe ekonomisë, gjatë qendrimit të tyre në Elbasan.

Ditët e informimit të maturantëve

Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", janë zhvilluar në datat 22,23,24,25,28 shkurt dhe në datat 1,2 mars takimi me maturantët e shkollave të mesme. Takimet janë zhvilluar në kuadër të "Ditët e informimit të maturantëve", me qëllim njohjen dhe informimin e nxënësve maturantë me universitetin, programet e studimit, personelin akademik, ndërkombëtarizimin dhe mundësitë e tjera të pafundme për ta.



"Zëri i grave dhe vajzave"



Është zhvilluar në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", tryeza e shtatë e rumbullakët e çështjeve të barazisë gjinore me temë "Zëri i grave dhe vajzave". Në takim u trajtua mbrotja e grave dhe vajzave, fuqizimi i zërit të tyre në shoqëri, garantimi i pjesëmarrjes së barabartë në vendimarrje, projektet e vazhdueshme që ndërmerren për të rritur rolin aktiv të vajzave dhe grave.

Prezantohet libri i Prof.as.dr. Ardjan Turkut



Prezantohet libri i Prof.as.dr. Ardjan Turkut "Formësimi i kompetencave të mësuesve të rinj, përmes praktikave profesionale". Ky prezantim vjen si pjesë e aktiviteteve që FSHE "organizon" në kuadër të nismës "Muaji Mars muaji i mësuesisë në FSHE".



Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" dhe Institutit Konfuci


Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", u nënshkrua, në prani të Ambasadorit të Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri, Zhou Ding, marrëveshja e bashkëpunimit mes Universitetit të Elbasanit dhe Institutit Konfuci. Në takimin e zhvilluar, rektori i këtij universiteti Prof.dr. Skender Topi, shprehu falenderimin dhe angazhimin e plotë institucional, për krijimin e bashkëpunimeve të vazhdueshme, duke mundësuar marrëveshje për shkëmbime ndëruniversitare dhe të specializuara, implementimin e gjuhës kineze dhe ofrimin e strukturave për zhvillimin e saj. Ambasadori Zhou Ding, shprehu vlerësimin e tij, për gatishmërinë dhe mbështetjen nga ana e Z.Skender Topi, për mundësimin e bashkëpunimeve të ndërsjellta në fushën akademike, duke krijuar hapësira për implementimin, promovimin dhe zhvillimin e kurseve mësimore të gjuhës dhe kulturës kineze nga studentët e të gjithë fakulteteve. Në vijim të takimit, përfaqësues të Institutit Konfuci, i prezantuan studentët me procedurat për regjistrimin në kursin e gjuhës dhe kulturës kineze.



"Ceremoni promovimi"

Qendra kërkimore e studimeve albanologjike dhe ballkanologjike "Aleks Buda" (QSAB), UE "Aleksandër Xhuvani", organizoi sot ceremoninë e promovimit të dy librave, "Dukuri dhe personalitete në albanologji", me autorë Prof.dr. Liman Varoshi dhe bashkautor Dr. Mustafa Kadzadej dhe "Elbasani, personalitete, ngjarje e dukuri historike", me autor Prof.dr. Roland Gjini.

Kjo ceremoni, u zhvillua në homazh të 1-vjetorit të ndarjes nga jeta të Profesor Liman Varoshi. Në fjalën e tyre ndanë mendime, vlerësime e kujtime Zv/Rektori i UE "Aleksandër Xhuvani" Prof.dr. Peçi Naqellari, Dekani i FSHH-së, Prof.as.dr Albert Riska, akademikët Beqir Meta, Akademia e Shkencave dhe Hamit Kaba, Instituti i Historise/ASA, profesorë, kolegë të autorëve, si edhe miq e familjarë të tyre.



Marketingu dhe komunikimi



Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", është zhvilluar workshopi me temë "Marketingu dhe Komunikimi", prezantuar nga Z.Edmond Kristo, menaxher dhe dr.marketingu i Zhan 92. Në takim studentët, u prezantuan me rëndësinë që ka komunikimi në përditshmërinë tonë, në marrëdhënie me të tjerë, në fushën profesionale, njohja e teknikave të komunikimit dhe përdorimi i tyre në fushën e marketingut. Ky takim u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit me Bordin Këshillimor të Biznesit.

Klubi i debatit



Në Fakultetin Ekonomik, u zhvillua trajnimi "Klubi i debatit", ku studentët, u njohën me hulumtimin shkencor, metodat e kërkimit shkencor, shkrimi akademik, fazat përmes të cilit zhvillohet hulumtimi shkencor, plagjiatura etj. Përmes organizimit të këtyre trajnimeve, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", synon të aftësojë studentët në fushën e kërkimit shkencor dhe në rritjen e cilësisë së tij.

Seancë dëgjimore



Mbahet në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", seanca dëgjimore dhe konsultimi, nga Komisioni Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Në këtë seancë u diskutua mbi depistimin e skoliozës dhe trajtimin e saj në nxënësit e shkollave.